Kapet arsenal armësh brenda një furgoni në Tiranë, sekuestrohen 23 armë, prej tyre 5 snajper e 1 silenciator! Pranga 34-vjeçarit, në kërkim dy të tjerë (VIDEO)

Përveç 23 armëve që dyshohet se janë trafikuar nga Kosova, u gjetën edhe 15 000 fishekë, pjesë të ndryshme armësh, pranga dhe uniforma policie, pajisje për shpërthime nga distanca, gjurmuese, për bllokimin e valëve dhe për numërimin e kartëmonedhave. Ndërkohë janë dhe dy të tjerë.

- Arsenali i armëve u trafikua nga Kosova, dyshohet se i përkasin një grupi me bazë në Tiranë, Laç e Burrel
- U kap me furgonin të mbushur plot me armë, Report Tv siguron foton e 34-vjeçarit

HOROSKOPI

Lajmi i fundit

Vuçiç i mohon akuzat se qëndron pas incidenteve antiturke në Mal të Zi

29 Tetor, 20:37

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

Sh.com Redaksia
29 Tetor, 10:20 | Përditësimi: 29 Tetor, 14:53

Share

TIRANË – Një arsenal armësh u kap sot në rrugën Myslym Shyri në Tiranë, teksa po transportoheshin me furgon. Në pranga u vu 34-vjeçari Eugert Sino, ndërsa në kërkim u shpallën dy persona të tjerë si të përfshirë, por policia nuk e zbulon identitetin e tyre për shkak të hetimit. Po ashtu, bluté gjetën edhe bazën ku mbaheshin armët, e cila sipas burimeve, ekziston pranë zonës pëmreth ku u krye ndalimi i furgonit.

Në total brenda furgonit u gjetën 23 armë zjarri të llojeve të ndryshme, 5 prej të cilave snajperë dhe 1 silenciator, 15 000 fishekë, kuti me pranga dhe uniforma policie, pjesë armësh, pajisje për shpërthime në distancë dhe gjurmuese etj. Siç shihet edhe nga pamjet e policisë, disa prej armëve ishin të futura rafaqi kuti.

Më konkretisht, 12 janë pistoleta të llojeve "Beretta", "Glock", "Rex Delta", "Ruger-57" dhe "Tanfoglio"; 6 armë automatike; 5 armë me tytë të gjatë (me shënjestër optike, të ngjashme me snajper); 1 silenciator; 17 krehra për armë zjarri të ndryshme; pjesë të ndryshme armësh zjarri; 15 000 fishekë; 17 kuti me pranga të ngjashme me ato që përdoren nga Policia; 12 celularë dhe pajisje që përdoren për shpërthime në distancë; pajisje elektronike gjurmuese (GPS); pajisje për bllokimin e valëve; pajisje për numërimin e kartëmonedhave; 3 komplete uniformash të ngjashme me ato të Policisë.

Gazetari Sokol Dema raporton se armët dyshohet se ishin planifikuar të përdoreshin në ngjarje kriminale nga një grup kriminal me bazë në Tiranë, Laç dhe Burrel. Hetuesit kanë zbuluar, përveç autorëjetë që u kap në zonën e "Myslym Shyrit", edhe bazën kryesore të grupit, ku mbaheshin armët, në po të njëjtën zonë në afërsi.

LEXO EDHE

Asistoi në lindjen e katërnjakëve, mjeku Ndërim Horeshka: Ishte shtatzëni me risk të lartë! Nëna nuk pranoi abortin

Armët e kapura janë relativisht të reja, dhe dyshohet se janë trafikuar nga Kosova, por nuk kanë lidhje me godëjet e mëparshme që janë bërë për trafik armësh. Hetuesit po punojnë për identifikimin e personave të tjerë që mund të jenë pjesë e njëtit. I arrestuari Eugert Sino, rezulton me precedent të mëparshëm për vepra penale të ndryshme.

Policia thotë se po heton për të tjerë të përfshirë ndërsa materialet janë referuar në Prokurori për vepra penale "Trafikimi i armëve dhe i municionit" dhe "Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyese dhe i municionit".

Rendit zhvillimet sipas orarit: Të Fundit

Ora 10:56

U kap me furgonin të mbushur plot me armë, Report Tv siguron foton e 34-vjeçarit

Eugert Sino

Report Tv ka siguruar foton e 34-vjeçarit Eugert Sino, i cili u arrestua pasi u zbulua një furgon me arsenal armësh në Tiranë.

SI.E./Shqiptarja.com Share

Ora 10:54

Arsenali i armëve u trafikua nga Kosova, dyshohet se i përkasin një grupi me bazë në Tiranë, Laç e Burrel! Zbulohet edhe baza, Sino me precedentë penalë



23 armë e kapura në një furgon në Tiranë dyshohet se ishin planifikuar të përdoreshin në ngjarje kriminale nga një grup kriminal me bazë në Tiranë, Laç dhe Burrel. Hetuesit kanë zbuluar, përveç autorëjetë që u kap në zonën e "Myslym Shyrit", edhe bazën kryesore të grupit, ku mbaheshin armët, në po të njëjtën zonë në afërsi.

Armët e kapura janë relativisht të reja, dhe dyshohet se janë trafikuar nga Kosova, por nuk kanë lidhje me godëjet e mëparshme që janë bërë për trafik armësh. Hetuesit po punojnë për identifikimin e personave të tjerë që mund të jenë pjesë e njëtit. I arrestuari Eugert Sino, rezulton me precedent të mëparshëm për vepra penale të ndryshme.

Xh.D./Shqiptarja.com Share

Ora 10:33

Pistoleta të disa lojeve, 5 snajperë e 1 silenciator, ja arsenali i armëve që u kap në Tiranë! U gjetën dhe 15 mijë fishekë dhe pajisje gjurmimi e shpërthimi në distancë

Policia e Tiranës ka sekuestruar një arsenal armësh, të cilët u kapën në një furgon që drejtohej nga 34-vjeçari Eugert Sino. Armët e zjarrit ishin të markave të ndryshme, ndërsa 5 janë snajperë dhe 1 silenciator. Disa prej armëve ishin futur në kuti, ndërsa u gjetën gjithashtu edhe 15 mijë fishekë, pajisje të ndryshme për shpërthime në distancë, gjurmim dhe bllokimin e valëve.

U sekuestruan:

-12 armë zjarri pistoletë të markave "Beretta", "Glock", "Rex Delta", "Ruger-57" dhe "Tanfoglio";
-6 armë zjarri automatike;
-5 armë zjarri me tytë të gjatë (me shënjestër optike, të ngjashme me snajper);
-1 silenciator;
-17 krehra për armë zjarri të ndryshme;
-pjesë të ndryshme armësh zjarri;
-15 000 fishekë;
-17 kuti me pranga të ngjashme me ato që përdoren nga Policia;
-12 celularë dhe pajisje që përdoren për shpërthime në distancë;
-pajisje elektronike gjurmuese (GPS);
-pajisje për bllokimin e valëve;
-pajisje për numërimin e kartëmonedhave;
-3 komplete uniformash të ngjashme me ato të Policisë.

Xh.D./Shqiptarja.com Share

Xh.D./Shqiptarja.com

TAG: Tirana armë zjarri policia e trajnes Eugert Sino

Komentoj

Komente

EDVIN.K@GMAIL.COM. 29/10/2025 16:55
ME KETE ARMATIM BEHET DRUSHT SHTETI ..... NJE BRAVO TE MADHE POLICIA
Përgjigju

LORA: 29/10/2025 14:35
Ky asthe armatim per terrorizem shtetaror. Mendoj qe hetimi i hollesishem do te nqjerre shume njerez te perfshire. Respekt per punen e policise.
Përgjigju

Eri. 29/10/2025 11:37
Kjo qenka godëza, bravo Policia. Nga pershkrimi gjeografik, duhet jene te grupit te Monopolit dhe mbetjene te Via Martinaj.
Përgjigju

Poso eri. 29/10/2025 13:00
Si e gjetë ti dhe mbetjet e p...motres tende

Ndalohet riprodhimi i pjesëshëm ose i plotë i shkrimit, sipas nenit 80, ligji 35/2016

SH

Sondazhi i ditës:
A e mbështesni kërkesën e PD për shkarkimin e Niko Peleshit?

29 Tetor, 10:14

Po Jo Nuk kam mendim

Lajme të tjera

Transporti i pasagjerëve nga Rinasi shënoi rritje me 10.1% në tremujorin e tretë 2025

29 Tetor, 19:51

3 vrasjet në një ditë/ Ekspertët i Sigurisë për Report Tv: Problemet e shëndetit mendor në rritje! Sociologja: Faktor ndikues edhe lëndët narkotike

29 Tetor, 17:44

BE kërkon përfundimin e vetingut deri në qershor, ambasadori Gonzalo: Subjekt ndaj ONM të papranueshme

29 Tetor, 17:32

E mitura nga Delvina konsumon medikamentet e familjarit me Parkinson, transportohet me helikopter në QSUTI 12-vjecarja në gjendje të qëndrueshme

Linos Dilaxi

29 Tetor, 17:26

Manastirliu takime me bankët: Plani ynë Tirana 2030, i prekshëm për çdo komunitet

29 Tetor, 16:57

Tiranë/ Dy të vdekur nga aksidentet në punë në Dorëzë! Arrestohet njëri nga administratorët, shpallet në kërkim tjetri! Nis hetimi për 52-vjeçarin

29 Tetor, 15:15

'E marta e zezë'/ Picieri në Tiranë, turisti në Berat dhe babai në Durrës u vranë me thikë për një fjalë gojë! Zbardhen dëshmitë e autorëve

Sokol Dema

29 Tetor, 13:08

Lëvizje të reja në Policinë e Shtetit/ Emrat e rinj të Prodis në disa qytete, një grua në krye të Komisariatit të Librazhdit!

Sokol Dema

29 Tetor, 18:51

Manastirliu me të rinjtë në Laprakë: Plani ynë Tirana 2030, qytetit i mundësive për të rinjtë

29 Tetor, 12:35

Arsenali i armëve u trafikua nga Kosova, dyshohet se i përkasin një grupi me bazë në Tiranë, Laç e Burrel! Zbulohet edhe baza, Sino me precedentë penalë

29 Tetor, 10:54

Pistoleta të disa lojeve, 5 snajperë e 1 silenciator, ja arsenali i armëve që u kap në Tiranë! U gjetën dhe 15 mijë fishekë dhe pajisje gjurmimi e shpërthimi në distancë

29 Tetor, 10:33

© 2011 - 2025 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje